

## Një Histori...

Që në fëmijëri shfaqen pakënaqësira sepse jeta nuk është ashtu siç do ta dëshironin, edhe pse prindërit përpiqen të mos u mungojë asgjë fëmijëve.



Fëmijët rriten, por shpesh salla e ngrënjes është e heshtur dhe e pushtuar nga imazhet dhe zërat televizivë. Ndodh kështu që muret e shtëpisë bëhen të vegjël për hapësirat e ëndërrave të një adoleshenti.



...ëndërrohet gjithnjë e më tepër jeta vezulluese, shkëlqyese, premtuese, dehëse, liri dhe lumturi, për tu ndjerë “të ndryshëm” dhe për të lehtësuar ose mbytur apo tejkaluar një boshllëk, një vuajtje karakteri, një ndrojtje apo një kompleks, një plagë, një kufi, një varfëri, një pakënaqësi.



Dhe ja më në fund gjendet një arsye për të jetuar: të marrësh e të shtrëngosh në grusht pjesë të asaj lirie-superioriteti-lumturie që të “shkel syrin” nga të gjitha këndet e jetës së mëdhenjeve, nga modelet e të sjellurit të madhështisë mondane, të mirëqenies socio-ekonomike, nga sukcesi i bujshëm i një farë bote politike- kulturore, sportive rikrijuese, zbavitëse...



Ndizet fantazia, niset zemra, nisen edhe këmbët. Dilet nga shtëpia dhe shkohet nëpër lagje...



NUK KA AKOMA “DROGË”, APO KA?

Nuk ka punë ose nëse ka është e rëndë.

Boshllëku dhe pakënaqësia kërkojnë të arratisen.



<p>Ëndërrohet më aktivisht gjithçka që premtion më shumë kënaqësi, forcë, siguri, bollëk...</p>	
<p>Dilet në mbrëmje, dhe jeton natën...</p> <p>MBASE NUK KA AKOMA DROGË APO KA?</p> <p>PO! TASHMË KA! ËSHTË E GJITHA!</p> <p>ËHTË TMERRËSISHT MENTALITET I DROGUAR!</p>	
<p>Por ky mentalitet është pjellë e kohës tonë, është manifestim i këtij civilizimi. Mbase për këtë arsye është e vështirë ta njohësh atë si një shkak të thellë i shumë të këqijave, mbase për këtë është kaq e vështirë të mundësh shkatërrimin e drogës. Po, sepse mundohemi të kurojmë pasojat pa ndërhyrë mbi shkaqet.</p>	
<p>Të këqijat nga të cilat vuajmë kërkojnë një</p> <p><i>“revolucion të vërtetë kulturor të brendshëm”</i></p> <p>që duke u nisur nga zemra e secilit prej nesh të arrijë në familje, në shkollë, shoqëri: në lagje, qytet, rreth, komb...</p>	
<p><i>At Mario Marafioti, Themelues i Komunitetit Emmanuel</i></p>	

**"Ndryshoje botën nga të mundësh, nise nga vetja!"**

**"Nëse shumë njerëz pak të rëndësishëm në shumë vende pak të rëndësishme do të bënin me dashuri shumë gjëra pak të rëndësishme, bota do të ndryshonte"**